



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 12, DATË 30 / 12 / 2025

PËR

**MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “EAGLE EYE” ME SUBJEKT APLIKUES “GMD
SHPK ME NUIS M42805201U**

Në mbështetje të neneve 8, 9, 13 dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “*Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë*”, Kreut I, pika 3/c të VKM-së Nr. 1023, datë 16.12.2015 “*Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi*” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “*Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike*”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti “Eagle Eye” synon zhvillimin e një kompleksi në të cilin përfshihen ndërtimi i hoteleve me 4- 5 yje, “village housing”, vila individuale, struktura të përkohshme në funksion të shërbimit, parqe rekreative, në ZK 2863, fshati Palasë, Bashkia Himarë.
- Projekti propozohet të realizohet nga subjekti “GMD” sh.p.k. me NUIS M42805201U.
- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 100,000,060 Euro (njëqind milion e gjashtëdhjetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 140 (njëqind e dyzet) punonjës.

- Projekti i propozuar synon realizimin në një sipërfaqe totale zhvillimi prej afërsisht 48.82 ha, me vendndodhje në ZK 2863, Bashkia Himarë.
- Subjekti kërkon si masë mbështetëse dhënien e së drejtës së përdorimit të sipërfaqes prej 48.82 ha, pjesë të pasurisë së paluajtshme shtetërore, me nr. 30/261 në ZK 2863.
- Pasuria shtetërore ku synon të zhvillohet projekti me nr. 30/261 në ZK 2863, rezulton të ketë kufizime që lidhen me tituj pronësie të regjistruara në emër të subjekteve të treta private, të lëshuara nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave.
- Situata juridike lidhur me këtë pasuri, aktualisht rezulton të jetë e paqartë për shkak të pamundësinë teknike të identifikimit dhe planvendosjes hartografike të pronës së trajtuar me vendimin e lartpërmendur dhe gjurmës së propozuar për zhvillim.
- Në pasurinë që pretendohet zhvillimi i projektit të propozuar, Bashkia Himarë po trajton mundësinë e zhvillimit të një projekti në funksion dhe bazuar kërkesave të komunitetit, zhvillimi i të cilit kushtëzohet gjithashtu nga qartësimi i statusit juridik të pasurisë.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit me potencial strategjik “Eagle Eye”, me subjekt investues “GMD” sh.p.k. me NUIS M42805201U, fshati Palasë, Bashkia Himarë, në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Sipërfaqja e gjurmës së synuar në pasurinë me nr. 30/261 në ZK 2863, në bashkinë Himarë e cila kërkohet si masë mbështetëse për vendosje në dispozicion për zhvillimin e projektit, rezulton të jetë trajtuar me vendime të cilat përbëjnë tituj pronësie në emër të subjekteve të treta private të cilat prekin në mënyrë direkte situatën juridike të pronës.
3. Projekti në fjalë nuk vlerësohet i maturuar, duke qenë se mungojnë të dhëna të detajuara dhe informacioni i plotë kadastral për gjurmën e synuar si masë mbështetëse.

4. Projekti i propozuar nuk është në përputhje me vizionin dhe strategjinë aktuale të zhvillimit të zonës së interesit. Në këtë zonë, qeveria dhe institucionet përkatëse kanë hartuar dhe harmonizuar një sërë nismash dhe planesh strategjike që synojnë një model të caktuar zhvillimi. Projekti i paraqitur nuk reflekton koherencë me këto prioritete dhe drejtime të përcaktuara, duke mos u integruar në mënyrë të përshtatshme në kuadrin ekzistues zhvillimor.
5. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA

MINISTËR I MJEDISIT

SOFJAN JAUPAJ

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)